PSH.nr.925/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: N.T.P "AGONITI " - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: "AOME" SHPK & NTSH-"TINI", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me dru dhe pelet për Institucionet komunale për ngrohje" , me nr. të prokurimit: OB614-20-4638-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK OBILIQ, më datën: 09.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e pa bazuar ankesa e operatori ekonomik "N.T.P "AGONITI " - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me dru dhe pelet për Institucionet komunale për ngrohje" , me nr. të prokurimit: OB614-20-4638-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK OBILIQ.

II. **ANULOHET** , **vendimi i AK-së** -njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me dru dhe pelet për Institucionet komunale për ngrohje" , me nr. të prokurimit: OB614-20-4638-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK OBILIQ, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "N.T.P "AGONITI " - Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "N.T.P "AGONITI " - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 12.11.2020 me nr. 925/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me dru dhe pelet për Institucionet komunale për ngrohje" , me nr. të prokurimit: OB614-20-4638-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK OBILIQ, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 2, 6, 7, 59, 60, 64, 65, dhe nenin 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe neni 4 i RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 13.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 23.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm, për faktin se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe Njoftimit për kontratë, përkatësisht kërkesën e përshtatshmërisë profesionale, Neni 7.1&7.2,kërkesa 3.

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e Dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "*Operatori ekonomik duhet të jetë I licencuar nga Agjencia e Pylltarisë se Kosovës për prerje dhe transport te drunjve"*,Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "*Kopje e Licencës (e vlefshme)*"

Lidhur me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues sqaron se njeri anëtar i konzorciumit të OE të rekomanduar për kontratë ka ofruar licencën e cila është kërkuar në FDT dhe Njoftimi për kontratë e lëshuar nga Ministria e Bujqësisë pylltarisë dhe zhvillimit rural e Republikës së Kosovës, e cila i ka të gjitha të

dhënat e nevojshme konform Dosjes së tenderit.

Duke pas parasysh që kërkesa e FDT-së dhe njoftimit për kontratë është përmbushur nga anëtari i konzorciumit "AOME" ky pretendim i OE ankues është i pa qëndrueshëm për faktin se dëshmia e ofruar është konform Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

Po ashtu ne pajtim me nenin 9 paragrafi 2 te ***Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP-së dhe vlera e tarifave të ankesave.*** Eksperti shqyrtues ka dhen përgjigje vetëm në pretendimet që kanë qen të njëjta me ato të kërkesës për rishqyrtim.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE "AGONITI " Prishtinë të refuzohet si e pa bazuara, dhe të vërtetohet njoftimi i AK-së për dhënie të kontratës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 24.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se PAJTOHET me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Obiliqit pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues për projektin **Furnizim me dru dhe pelet për institucionet komunale (DA , DSHMS dhe DKRS)**

- AK duke u bazuar në sqarimet e ekspertit po edhe në ekzaminimin dhe vlerësimin e AK, i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE Agoniti të refuzohet si e pa bazuar, dhe të vërtetohet njoftimi i AK për dhënie të kontratës.

Operatori Ekonomik, me datë: 25.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se NUK PAJTOHET me mendimin e ekspertit shqyrtues

Ne konfirmojmë pranimin e ekspertizës Nr.925/20 të dt.23.11.2020 dhe ju informojmë se **NUK** pajtohemi me konstatimin e ekspertit shqyrtues.

Sa i përket konstatimit të ekspertit shqyrtues ku ka konstatuar se OE i rekomanduar për kontratë e plotëson kërkesën në lidhje me licencën nga Agjencia e Pylltarisë së Kosovës për prerje dhe transport të drunjëve, ju sqarojmë se nuk pajtohemi me këtë konstatim të ekspertit shqyrtues, sepse është shumë e qartë se njëri nga anëtarët e konzorciumit nuk e posedon licencën nga Agjencia e Pylltarisë se Kosovës për prerje dhe transport të drunjëve, mirëpo e posedon vetëm njëri nga anëtarët e konzorciumit. Pra kërkesa ka qenë shumë e qartë se Operatori ekonomik duhet të jetë i licencuar nga Agjencia e Pylltarisë se Kosovës për prerje dhe transport te drunjëve. Pra përderisa kjo kërkesë ka qenë e vendosur tek kërkesat e përshtatshmërisë, ku siç e dijmë

kërkesat e përshtatshmërisë edhe në rast të konzorciumit duhet të përmbushen nga të gjithë OE dhe jo vetëm nga lideri i grupit.

Andaj duke u bazuar në këtë fakt, shihet qartë se konstatimi i ekspertit se njëri anëtar i konzorciumit e posedon licencën është krejtësisht i pa bazuar.

Gjithashtu eksperti shqyrtues në ekspertizën e tij është treguar shumë jo profesional, sepse tek kriteret për vlerësim i ka vendosur kërkesat e kaluara të dosjes së tenderit dhe jo kërkesat të cilat janë ndryshuar nga na e AK-së.

Ky fakt tregon jo profesionalizmin e ekspertit shqyrtues në lidhje me shqyrtimin e ankesës tonë.

Duke u bazuar në ankesën që e kemi parashtruar, në ekspertizën e ekspertit shqyrtues dhe në të gjitha faktet tona, kërkojmë nga paneli shqyrtues që të aprovohet ankesa jonë si e bazuar, dhe të konfirmohet përgjegjshmëria e jonë dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 09.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimet e OE ankues N.T.P "AGONITI " – Prishtinë se OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm, për faktin se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe njoftimit për kontratë, përkatësisht kërkesën e përshtatshmërisë profesionale, Neni 7.1&7.2, kërkesa nr.3. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se kërkesë e Dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "*Operatori ekonomik duhet të jetë I licencuar nga Agjencia e Pylltarisë se Kosovës për prerje dhe transport te drunjve*", Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "*Kopje e Licencës (e vlefshme)*" Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se njeri anëtar i konzorciumit të OE të rekomanduar për kontratë ka ofruar licencën e cila është kërkuar në FDT dhe njoftimi për kontratë e lëshuar nga Ministria e Bujqësisë pylltarisë dhe zhvillimit rural e Republikës së Kosovës, e cila i ka të gjitha të dhënat e nevojshme konform dosjes së tenderit. Andaj, duke pas parasysh që kërkesa e FDT-së dhe njoftimit për kontratë është përmbushur nga anëtari i konzorciumit "AOME" ky pretendim i OE ankues është i pa bazuar për faktin se dëshmia e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë është konform dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së, sepse neve i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e dosjes së tenderit por jemi shpallur të pa përgjegjshëm ku AK nuk ka kërkuar sqarime nga

ne. Paneli shqyrtues duke pas parasysh arsyet e eliminimit te cekura ne letrën standarde për tenderuesin e eliminuar për OE ankues konstatojmë se me rastin e rivlerësimit autoriteti kontraktues duhet te kërkoj sqarime shtesë nga OE ankues për pikat që janë te lejuara sqarimet sipas nenin 72 dhe 59 të LPP-së. Prandaj me rastin e rivlerësimit AK te kërkoj sqarime nga OE ankues ashtu siç u theksua si më lart.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ka dhen përgjigje vetëm në pretendimet ankimore që kanë qenë të njëjta me ato të kërkesës për rishqyrtim ne pajtim me nenin 9 paragrafi 2 te *Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP-së dhe vlera e tarifave të ankesave.*

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së, dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK KK OBILIQ;

1x1 OE "AGONITI " – Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.